



Rrapaj: 5 milionë euro për fermerët, lajm i mirë
 Fermerët që duan të investojnë në serra, stalla bagëtitsh apo akuakulturë do të mbështeten me grante...
 Faqe 2

Skema e investimeve në bujqësi, Kuçi: Aplikimet për grante nga data 30 shtator deri më 8 nëntor
 Faqe 2

Efeti i fondeve, 25 mijë fermerë futen në skemën e sigurimeve. 6-mujori, rritje me 15.2 për qind krahasuar me 2023, kryeson Fieri
 Faqe 4



AGROBIZNESI

FED invest
 Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
 Tel: +355 4 2 251 910 /911
 Email: info@fedinvest.al
 kontakt@fedinvest.al
 www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR
 Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
 E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit shtator 2024 **Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 494** Çmimi 125 lekë E përdyjavshme e pavarur

UNIDO DHE QEVERIA ZVICERANE NË PARTNERITET PËR PËRFORCIMIN E CILËSISË SË PRODUKTEVE SHQIPTARE PËRMES TRAJNIMIT TË VLERËSUESVE TEKNIKË TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË AKREDITIMIT (DPA) PËRMIRËSIMI I PRODUKTEVE BUJQËSORE SHQIPTARE PËR TREGJET NDËRKOMBËTARE. ROLI I AKREDITIMIT DHE TRAJNIMIT TË VLERËSUESVE TEKNIKË

Akreditimi i laboratorëve të testimit sipas standardeve ndërkombëtare dhe trajnimi i vlerësuesve teknikë janë thelbësorë për rritjen e cilësisë dhe sigurisë së produkteve bujqësore shqiptare. Roli i DPA-së është kyç për vendosjen e standardeve të larta të cilësisë dhe kompetencës, duke i bërë ato normë në sektorin bujqësor të Shqipërisë

GOSP ALBANIA
 GLOBAL QUALITY AND STANDARDS PROGRAMME
Programi Global Për Cilësi dhe Standarde

 UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION
 Schweizerische Eidgenossenschaft
 Confédération suisse
 Confederazione Svizzera
 Confederaziun svizra
 Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



Denaj-Burtscher: Integrimi evropian, prioritet në politikat bujqësore

 Faqe 2

FED INVEST
Financa e qëndrueshme gjithëpërfshirëse në Shqipëri, Historia e transformimit të FED invest
 Faqe 6

KËNDI I BOTIMEVE TË REJA PËR BUJQËSINË
Bujqësia biologjike 2025 dhe përgatitjet paraprake
 Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike
 Faqe 11, 12
TEMA TË DITËS

- Luledielli i rrezikuar nga çmimi - Fermerët në Divjakë hoqën dorë nga gruri për këtë kulturë bujqësore, por tregu po tkurret Fq.5
- Produktet e bulmetit, rekord absolut importesh në Gusht - Vlera arriti në rreth 767 milionë lekë, ose rreth 33% më shumë se vjet Fq.5
- Më shumë vaj këtë sezon! Rritet prodhimi dhe sipërfaqet e mbjella me rrënjë ulliri në Fier Fq.10
- Fermerët ende nuk kanë marrë naftën! Po kryejnë punimet e vjeshtës pa mbështetjen e premtuar për vitin 2024 Fq.10
- Kalendari bujqësor, muaji tetor 2024 - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

SKEMA INVESTIMEVE
Skemat e mbështetjes për bujqësinë - Kreu i Këshillit të Agrobiznesit: Fermerët e bashkuar kanë më shumë përparësi

 Faqe 7

TEMA TË DITËS

Rrapaj: 5 milionë euro për fermerët, lajm i mirë

Fermerët që duan të investojnë në serra, stalla bagëtish apo akuakulturë do të mbështeten me grante nga buxheti i shtetit. Në mbledhjen e qeverise është miratuar Skema Kombëtare e Investimeve në Ferma aplikimet për të cilën do të hapen në 1 tetor. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Anila Denaj deklaroi të mërkurën se qeveria do të financoj 50% të investimit në formën e grantit.

Lidhur me këtë është diskutuar në emisionin "Sheshi i Dollarit", ku presidenti i KASH, Agim Rrapaj e konsideroi buxheti 5 milionë euro për fermerët një lajm të mirë.

Ndërsa, eksperti i bujqësisë, Ilir Pilku tha se me rëndësi është sigurimi i prodhimit për popullsinë. Sipas tij, është e pafalshme që të importojmë produkte që mund të prodhohen në vendin tonë.

"Ky 5 milionësh është një lajm i mirë në konceptin e këtyre muajve dhe ne duhet t'u

themi fermerëve të aplikojnë, sepse ka një mundësi reale që ata të marrin 30% të vlerës brenda këtij viti. Edhe kjo mund t'i jap mundësinë për të parë



Agim Rrapaj
Kreu i KASH

në vijimësi procesin. Unë do t'u bëja thirrje përsëri fermerëve që të rrisin aplikimet sepse është një presion ndaj qeverisë, ndaj ministrisë, në mënyrë të tillë që ne nuk jemi në situatën që nuk kemi nevojë. Ne

jemi në situatën e emergjencës për disbursuar sa më shumë fonde. Do të thosha që të disburosojmë sa më shumë fonde, sepse është domosdoshmëri.

Jo se ne nuk kemi sera për të mbjellë, por jemi në një moment që po diskutohet projekti i vitit tjetër dhe ne duhet të balancojmë nevojat dhe kërkesat tona, me nevojat dhe kërkesat që ka bujqësia", tha Rrapaj.

Investimet në ferma, 50 përqind nga qeveria - Jaupllari shpjegon skemën kombëtare

Zëvendës ministri i Bujqësisë, Arjan Jaupllari shpjegoi në emisionin "Sheshi i Dollarit" skemën mbështetëse të qeverisë për fermerët për vitin 2024. Ai

përfitojë grant nga kjo skemë. E ndarë për çdo kategori, për perimet do të jetë 15 milionë lekë për hektarë, për rrushin 18 milionë lekë dhe luleshtrydhet

kryesore të bujqësisë.

Sa i përket fermerëve të prekur nga ndryshimet klimatike, ai tha se duhet aplikuar siguracione.

"Mendoj se duhet të sqarojmë shifrat. Akti normativ i qeverisë së fundi nuk ka shtuar fondin për bujqësinë. Nga 141 milion euro është reduktuar në 139 mln euro sipas tabelës së buxhetit të shtetit të miratuar në parlament. Kemi ulje rreth 2 përqind të buxhetit për ministrinë e Bujqësisë. Më e rëndë është se janë prekur programi i sigurisë ushqimore, që është reduktuar me 134 milionë lekë, është prekur zhvillimi rural dhe menaxhimi i tokës dhe vetëmshkëmbim programi për menaxhimin e infrastrukturës së kullimit dhe ujtitjes. I thashë këto shifra, për të thënë se premtimi që ka dhënë ministria nuk ka ndodhur. Nuk është rritur por është ulur me 2.5 milionë euro.

Skema e mbështetjes është një shumë prej 5 milionë eurosh, është brenda buxhetit që ka ministria e bujqësisë. Nuk është shtesë. Këtu ka disa pikëpyetje, momenti i parë është bërë një studim paraprak për të përcaktuar se cilat janë problemet kryesore të bujqësisë. A është problem kryesor blerja e koshave të peshkut apo tonit, të disa personave që në një farë mase po i u ecën bizneset. E dyta, është që këto studime që janë bërë a kanë parashikuar se sa do të jetë fondi dhe impakti që këto para do të kenë në bujqësinë shqiptare. Tjetra është se gjithë bota po flet për ndryshimet klimatike, për masat për rrjetet që mos është e pjesshme. Duhet të vendosim siguracione në bujqësi, të cilat do të sigurojnë edhe nga breshëri dhe nga përmblytja apo zjarri", tha Vuksani.



tha se skema kombëtare e këtij viti është në fazën përfundimtare ndërsa shtoi se do të përfitojnë edhe fermerët të prekur nga ndryshimet klimatike.

"Skema kombëtare e këtij viti është në fazën përfundimtare për t'u dhënë paratë të gjithë fermerëve edhe pse një pjesë e buxhetit nuk është rialokuar akoma. Skema e re e mbështetjes me grante është një mbështetje tjetër që qeveria i bën bujqësisë, por në këtë rast, janë të përcaktuara saktë se kush dhe çfarë duhet të mbështetet dhe jemi fokusuar në 5 drejtime kryesore, prioritare për zhvillimin e bujqësisë. E para mbështetja me sera, do të mbështeten perimet, rrushi i tavolinës dhe luleshtrydhet.

Mbështetja do të jetë jo më pak se 0.2 hektarë dhe jo më shumë se dy hektarë. Masa e mbulimit është 50 përqind e vlerës totale të faturave tatimore që një fermer do të shpenzojë për ndërtimin e një sere, do t'i

14 milionë lekë për hektarë sipas përlllogaritjeve që janë bërë se sa shkojnë shpenzimet për të ndërtuar një lloj kategorie të këtyre serave.

Në Shqipëri kemi edhe dëmtime të mëdha si pasojë e kushteve klimatike, të cilat kanë bërë dëme sidomos në Korçë dhe jug te pemët frutore, te mollët, mandarinat dhe vreshtat prandaj rrjetëzimi ka qenë një nga objektivat e qeverisë. Me rrjetëzimin do të mbështesim fermerët dhe masa e mbulimit do të jetë 50 përqind, jo më pak se një hektarë dhe jo më shumë se 5 hektarë. Për çdo hektar, vlera do të jetë 1.5 milionë.", u shpreh Jaupllari.

Ndërkohë, Gjok Vuksani nga departamenti i Bujqësisë në PD tha se buxheti i shtetit për ministrinë e Bujqësisë është ulur. Duke u ndalur te skema kombëtare për fermerët, ai ngriti disa pikëpyetje. Sipas tij, duhet që së pari të ishte bërë një studim për të përcaktuar problemet

Denaj-Burtscher: Integrimi evropian, prioritet në politikat bujqësore

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj zhvilloi një takim me Wolfgang Burtscher, drejtor i përgjithshëm të DG-Agri, me të cilin diskutoi për zhvillimet e fundit për programin IPARD.

Denaj theksoi se "integrimi evropian për bujqësinë dhe zhvillimin rural është prioriteti ynë në politikat bujqësore, krahas angazhimit për përafrimin e kuadrit ligjor të Shqipërisë me atë të Bashkimit Evropian".

Programi IPARD II nisi në vitin 2018 pas një procesi të rëndësishëm akreditimi dhe trajnimit të kapaciteteve të brendshme institucionale.

Ky program ka kontribuar në rritjen dhe zhvillimin e njësive ekonomike të bujqësisë shqiptare, në përmirësimin e sigurisë ushqimore dhe në vlerën e shtuar të produktit shqiptar në tregjet ndërkombëtare.

Përmes programit IPARD II, janë realizuar 540 investime të rëndësishme në sektorë të ndryshëm bujqësor dhe janë krijuar 1000 vende

80 investime të programit në sipërmarrjet agroturistike, 46 investime në kantina vere dhe vreshta, 34 investime në stalla e ferma blegtorale, 40 fabrika



pune për familjet shqiptare, të cilat janë fokusuar, në 73 investime në sera, 137 investime në mekanikë bujqësore, 72 pika grumbullimi,

përpunimi agroushqimore, 31 investime janë zhvilluar në promovimin e përdorimit eficient të burimeve të energjisë së rinovueshme.

Denaj: Deri në 20 milionë lekë mbështetje për sipërmarrje të akuakulturës

Skema Kombëtare e Investimeve 2024 po fuqizon sektorin e akuakulturës duke ofruar financim për koshat dhe rrjetat e rritjes së peshkut.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj bëri të ditur se masa e përfitimit shkon në 50% të vlerës totale të investimit, deri në 20

milionë lekë për subjekt.

Ministria theksoi se aplikimet për këtë skemë financimi do të hapen së shpejti.

"Ky investim është një hap konkret për të garantuar zhvillimin e qëndrueshëm të akuakulturës detare dhe mbështetur vizionin qeverisës për të arritur 30 mijë tonë peshk akuakulturë

deri në 2030", shtoi Denaj.

Me këtë shtytje të re synohet fuqizimi i sektorit si dhe rritja e punësimit direkt dhe indirekt në të gjithë zinxhirin e vlerës, i cili sjell ekonomi më të mirë për komunitetet e zonave bregdetare dhe më shumë mundësi për shitjen e produkteve të peshkut "Made in Albania" në tregjet e eksportit.

Skema e investimeve në bujqësi, Kuçi: Aplikimet për grante nga data 30 shtator deri më 8 nëntor

Aplikimet për Skemën Kombëtare të Investimeve në Bujqësi 2024, hapen në datën 30 shtator dhe do të vijojnë deri më datën 8 nëntor të këtij viti, për të gjithë fermerët dhe subjektet që duan të investojnë në prodhimin bujqësor në serra, blegtori, akuakulturë; makineri bujqësore, rrjeta antibreshër.

Lajmin e bëri të ditur drejtoresha e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, Ardita Kuçi, e cila zbardhi detaje mbi kriteret dhe zbatimin e skemës së re në mbështetje të fermerëve dhe bujqësisë.

Sipas saj, pas aplikimit fermerët ose subjektet i nënshtrohen procesit të kontrollit administrativ, për të parë nëse ka ndonjë mungesë dokumentacioni dhe më pas vijohet me kontrollin në terren.

Kuçi vuri në dukje se, fermerët që përbushin kontrollin administrativ dhe atë në terren, nënshkruajnë kontratën për grantin, përkundëjt

një polici sigurimi apo një garancie bankare, duke pasur mundësinë që të marrin 30% të fondit parapagesë.

Ky parapagim u jep atyre më shumë likuiditet që të vi-

me synim zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit" tha ajo.

Skema Kombëtare e Investimeve me një fond 500 milionë lekë, ka si qëllim nxitjen e zhvillimit dhe modernizimit



jojë punimet në investimin e parashikuar dhe më pas marrin vlerën tjetër prej 20%.

"I japim përparësi fermerëve në moshë të re si dhe investimeve në sipërfaqe të mëdha,

të sektorit bujqësor përmes mbështetjes financiare me 50% të vlerës së investimit grant, duke mbështetur zhvillimin dhe rritjen e bujqësisë së qëndrueshme.

UNIDO DHE QEVERIA ZVICERANE NË PARTNERITET PËR PËRFORCIMIN E CILËSISË SË PRODUKTEVE SHQIPTARE PËRMES TRAJNIMIT TË VLERËSUESVE TEKNIKË TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË AKREDITIMIT (DPA)

PËRMIRËSIMI I PRODUKTEVE BUJQËSORE SHQIPTARE PËR TREGJET NDËRKOMBËTARE. ROLI I AKREDITIMIT DHE TRAJNIMIT TË VLERËSUESVE TEKNIKË

Akreditimi i laboratorëve të testimit sipas standardeve ndërkombëtare dhe trajnimi i vlerësuesve teknikë janë thelbësorë për rritjen e cilësisë dhe sigurisë së produkteve bujqësore shqiptare. Roli i DPA-së është kyç për vendosjen e standardeve të larta të cilësisë dhe kompetencës, duke i bërë ato normë në sektorin bujqësor të Shqipërisë

Në epokën e globalizimit dhe integritimit ekonomik, produktet bujqësore shqiptare po përballen me sfida komplekse për të depërtuar në tregjet ndërkombëtare. Barrierat teknike, standardet e larta të cilësisë dhe sigurisë ushqimore, si dhe kërkesat rigoroze të konsumatorëve kërkojnë që prodhuesit dhe eksportuesit shqiptarë të përmbushin standarde ndërkombëtare. Një element vendimtar në këtë proces është akreditimi i laboratorëve që kryejnë teste dhe certifikime të këtyre produkteve. Akreditimi siguron që këto laboratorë të jenë kompetentë dhe të aftë për të kryer teste sipas standardeve të pranuar ndërkombëtarisht, duke garantuar besueshmërinë dhe saktësinë e rezultateve të tyre.

Çfarë është Akreditimi dhe pse është i rëndësishëm?

Akreditimi është një proces formal, ku një organ akreditues i njohur vlerëson dhe certifikon kompetencën teknike dhe menaxheriale të laboratorëve të testimit dhe kalibrimit. Në thelb, akreditimi sipas standardit ndërkombëtar ISO/IEC 17025:2017 siguron që një laborator ka aftësitë e nevojshme për të prodhuar rezultate të vlefshme dhe të besueshme, të cilat janë të pranuar globalisht. Përmes këtij

procesi, laboratorët verifikohen në aspektet teknike, si kompetenca e personelit, kalibrimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve, vlefshmëria e metodave analitike dhe siguria e rezultateve.

Për prodhuesit bujqësorë dhe eksportuesit, akreditimi i laboratorëve është thelbësor sepse garanton që testimet e

kryera janë në përputhje me kërkesat ndërkombëtare. Kjo ul ndjeshëm rrezikun e refuzimeve të produkteve në kufij për shkak të mosplotësimit të standardeve të sigurisë ushqimore, si nivelet e pesticideve, metaleve të rënda apo kontaminimeve mikrobiologjike.

Përfitimet Teknike dhe Komerciale të Akreditimit

Akreditimi sipas ISO/IEC 17025 sjell përfitime të shumta teknike dhe komerciale:

- Përmirësimi i Cilësisë së Produkteve: Sigurimi që produktet përmbushin standardet e kërkuara.
- Reduktimi i Kostove: Eliminimi i nevojës për teste të dyfishta apo ripërsëritje në vendet e destinacionit.
- Rritja e Konkurrueshmërisë: Produkte me certifikata të pranuar ndërkombëtarisht janë më konkurruese në tregjet globale.
- Lehtësimi i Tregtisë: Njohja reciproke e akreditimit lehtëson procedurat doganore dhe kufitare.
- Përmirësimi i Sistemeve të Menaxhimit: Zbatimi i praktikave më të mira në menaxhimin e laboratorëve dhe proceseve.

Roli i Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (DPA) në Sigurinë Ushqimore dhe Eksportet Shqiptare

Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) luan një rol kritik në mbikëqyrjen e laboratorëve që testojnë dhe certifikojnë cilësinë e produkteve ushqimore dhe bujqësore. Laboratorët e akredituar nga DPA janë të aftë të kryejnë analiza të besueshme që sigurojnë përputhjen e produkteve me standardet ndërkombëtare, një faktor thelbësor për suksesin e produkteve shqiptare në tregjet ndërkombëtare.

Shumë produkte bujqësore shqiptare janë refuzuar në kufi për shkak të mungesës së certifikatave të vlefshme të testimit ose për shkak të niveleve të larta të pesticideve. Ky problem mund të shmanget nëse produktet testohen në laboratorë të akredituar nga DPA, të cilët janë të njohur ndërkombëtarisht përmes marrëveshjeve të njohjes reciproke (EA-MLA dhe ILAC MRA). Këto marrëveshje sigurojnë që raportet e testimit nga laboratorët e akredituar në Shqipëri të jenë të pranueshme në të gjithë Evropën dhe më gjerë, duke rritur besueshmërinë e produkteve dhe duke lehtësuar lëvizjen e tyre në tregjet globale.

Në vitin 2016, Shqipëria nënshkroi marrëveshje të njohjes reciproke me EA dhe ILAC, duke u bërë një aktor i rëndësishëm në rrjetin ndërkombëtar të akreditimit. Kjo nënkupton që testet dhe certifikatat e lëshuara nga laboratorët e akredituar nga DPA janë të vlefshme në të gjithë Evropën, duke rritur besimin në produktet e testuara dhe duke zvogëluar barrierat teknike për eksportet.

Në përfundim, akreditimi i laboratorëve në Shqipëri përmes DPA është një garanci për besueshmërinë e produkteve bujqësore, ndihmon në shmangien e refuzimeve të produkteve në kufij dhe rrit aksesin e fermerëve shqiptarë në tregjet ndërkombëtare.

Sfidat e Produkteve Bujqësore Shqiptare dhe Roli i Akreditimit

Shqipëria ka potencial të madh në sektorin bujqësor, me një shumëllojshmëri produktesh që mund të jenë konkurruese në tregjet ndërkombëtare. Megjithatë, mungesa e infrastrukturës së cilësisë dhe e laboratorëve të akredituar ka qenë një pengesë kryesore. Produkte të shumta janë refuzuar në kufi ose kanë pësuar vonesa për shkak të mungesës së certifikatave të pranueshme të testimit.

Për shembull, nivelet e larta të pesticideve mbi kufijtë e lejuar nga BE kanë çuar në kthimin e ngarkesave të produkteve shqiptare. Këto probleme mund të shmangen nëse produktet testohen në laboratorë të akredituar, ku rezultatet e testeve janë të besueshme dhe të pranuar nga autoritetet ndërkombëtare.

Trajnimi i Vlerësuesve Teknikë të DPA - Garantimi i Kompetencës

Një aspekt kritik i sigurisë së cilësisë është kompetenca e vlerësuesve teknikë të DPA-së, të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në garantimin e cilësisë dhe sigurisë së produkteve bujqësore shqiptare, që synojnë tregjet ndërkombëtare. Këta profesionistë janë përgjegjës për vlerësimin e laboratorëve sipas kërkesave të ISO/IEC 17025:2017, duke siguruar që laboratorët të përmbushin standardet teknike dhe

menaxheriale të kërkuara.

Për të përforcuar më tej aftësitë e tyre, UNIDO (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial) or-



ganizoi një trajnim të specializuar më 24-26 shtator 2024 për 20 vlerësues teknikë të DPA-së. Trajnimi u fokusua në aspekte të avancuara të zbatimit të ISO/IEC 17025, duke përfshirë:

- Menaxhimin e Rrezikut dhe Mundësive: Identifikimi dhe menaxhimi i rreziqeve në proceset laboratorike për të siguruar vazhdimësinë dhe cilësinë e rezultateve.
- Validimin dhe Verifikimin e Metodave Analitike: Sigurimi që metodat e përdorura janë të përshtatshme për qëllimin e tyre dhe japin rezultate të sakta.
- Pjesëmarrjen në Teste Ndër-Laboratorike: Vlerësimi i performancës së laboratorit në krahasim me laboratorë të tjerë ndërkombëtarë.
- Gjurmueshmërinë Metrologjike: Sigurimi që matjet janë të gjurmueshme deri në standarde ndërkombëtare.
- Kalibrimin dhe Mirëmbajtjen e Pajisjeve: Procedura për të siguruar saktësinë e pajisjeve të matjes.
- Kontrollin e Cilësisë së Brendshme: Përdorimi i kontroleve të brendshme për të monitoruar dhe përmirësuar vazhdimisht proceset laboratorike.

Ky trajnim i avancuar i pajis vlerësuesit teknikë me mjetet dhe njohuritë e nevojshme për të kryer vlerësime të plota dhe të sakta të laboratorëve. Vlerësimet e kryera nga këta specialistë sigurojnë që produktet e testuara të kalojnë një proces rigoroz të kontrollit të cilësisë, duke garantuar që produktet shqiptare jo vetëm të përmbushin standardet ndërkombëtare, por edhe të jenë konkurruese në tregjet globale. Kjo qasje ndihmon në eliminimin e pengesave teknike dhe lehtëson eksportin e produkteve, duke rritur besueshmërinë dhe suksesin e tyre në treg.

Përfitimet e Trajnimit për Fermerët dhe NVM-të - Një Lidhje e Drejtpërdrejtë me Cilësinë dhe Eksportin

Për fermerët dhe NVM-të, akreditimi i laboratorëve të testimit jo vetëm që ndikon drejtpërdrejt në aftësinë e tyre për të eksportuar, por gjithashtu përmirëson cilësinë dhe konkurrueshmërinë e produkteve në tregjet vendase

INFORMACIONE

Ministria e Bujqësisë kërkon 2 mln euro garanci sovranë për fermerët. Sektori më i nënfinancuar punëson mbi 565 mijë persona

Ministria e Bujqësisë ka kërkuar nga financat një fond prej 2 milionë euro për vitin 2025, për tu përdorur si garanci sovranë për fermerët. Ky financim kërkohet për të mbështetur fermerët që të marrin kredi nëpër banka me kushte të lehtësuara, me normë interesi të favorshme dhe shteti del garant. Aktualisht bujqësia është sektori më pak i kredituar nga bankat në vend

Fermerët kanë nevojë për më shumë para nga buxheti i shtetit. Përtej skemës kombëtare të mbështetjes apo skemës së investimeve që pre-

që këtë vit, por që u shty, ndërsa kërkesa e fundit e ministrisë është që ajo të bëhet funksionale prej vitit 2025. Kjo garanci do tu jepte mundësi fermerëve

përfundimtar nga BE, për zbllokimin e fondeve të IP-ARD, që janë pezulluar prej më shumë se 1 viti. Aprovimi i kësaj garancie lehtëson aksesin e fermerëve nëpër banka për të marrë hua, pasi për një pjesë të kredisë del shteti garant, përmes këtij fondi të kërkuar.

Aktualisht bujqësia është sektori më pak i financuar nga sektori bankar, pasi biznesi i tyre është i pasiguruara, dhe fitimi i tyre rrezikohet nga kushtet atmosferike.

Vitin e kaluar bankat kanë dhënë për bujqësinë vetëm 2.7 miliardë lekë kredi, për sektorin që bashkë me agropëpunimin ka zyrtarisht më shumë se 565 mijë të punësuar, e që kontribuon deri në 18% në Prodhimin e Brendshëm Bruto të vendit. Ndërsa për këtë vit vlera e kredisë së dhënë deri në fund të korrikut ishte 1.8 miliardë lekë me rritje prej afro 708 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

KREDIA PËR BUJQËSINË

Janar-Korrik 2023	1,127 mln lekë
Janar-Korrik 2024	1,835 mln lekë
Rritja	+708 mln lekë



zantohet në tetor, që do të jenë funksionale edhe në vitin e ardhshëm, Ministria e Bujqësisë kërkon nga Ministria e Financave një fond prej 2 milionë eurosh garancie sovranë.

Në rast se kjo kërkesë e Ministrisë së Bujqësisë, e pasqyruar në programin buxhetor 2025-2027, do të pranohet, fondi prej 2 milionë euro do të përdoret si kolateral për bankat e nivelit të dytë, në mënyrë që të financojnë me kredi fermerët. Kjo linjë garancie në fakt u paralajmërua

të merrnin kredi me terma të butë, kushte të lehtësuara, norma të favorshme interesi si dhe do të kishin garanci shtetin.

Nëse ky fond garancie do të aprovohet do të ishte mbështetje e rëndësishme për fermerët në kushtet kur nuk ka një vendim

Efekti i fondeve, 25 mijë fermerë futen në skemën e sigurimeve. 6-mujori, rritje me 15.2 për qind krahasuar me 2023-shin, kryeson Fieri

Skemat e subvencioneve në bujqësi dhe më së shumti pagesat që jepen për naftën për kryerjen e punimeve të mekanizuara në bujqësi, po vijojnë të

dhënat në bazë qarqesh, Fieri zë vendin e parë për nga numri i kontribuuesve, ndjekur nga Elbasani, Vlora, Korça dhe Tirana. Ndërsa numri më i ulët regjis-

të derdhë kontributet për sigurimet shoqërore, kundrejt detyrimit tremujor, të llogaritur mbi bazën e masës vjetore prej 38, 400 lekësh.

Ndërsa ata që banojnë në zonat malore, paguajnë 29, 400 lekë në vit.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoritë Rajonale po ndërmarrin fushata të vazhdueshme të ndërgjegjësimit në terren, me qëllim që të vetëpunësuarit në bujqësi të përfitojnë nga avantazhet që ofrojnë skemat e dedikuara për këtë kategori.

Derdhja e kontributeve u jep të vetëpunësuarve në bujqësi të drejtën e përfitimit të pensionit. Pensioni i pleqërisë për këto kategori është mesatarisht 9,656 lekë në muaj,



EFEKTI I FONDEVE, 25 MIJË FERMERË FUTEN NË SKEMËN E SIGURIMEVE
6 MUJORI/ RITJE ME 15.2 PËR QIND KRAHASUAR ME 2023-SHIN, KRYESON FIERI

nxisin fermerët që të formalizohen, duke qenë se është kushti kryesor për përfitim. Po ashtu rritja e ndërgjegjësimit për nevojën e pagesës së kontributeve ka sjellë një shtim të numrit të të siguruarve që punojnë si të vetëpunësuar në bujqësi.

Referuar të dhënave zyrtare nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, për periudhën janar – qershor 2024 numri i të siguruarve si të vetëpunësuar në bujqësi arriti në 24,930, duke u rritur me 15.2% më shumë se njëjta periudhë një vit më parë.

Ndërsa viti 2023 u mbyll me një shifër prej 75.451 fermerësh kontribues në skemën e sigurimeve shoqërore.

Nëse do të analizojmë të

trohet në Kukës. Por sa është masa e kontributit që dredhin



të vetëpunësuarit në bujqësi? Referuar legjislacionit në fuqi, i vetëpunësuarit në bujqësi, që banon në zonat fushore, duhet

i invaliditetit 8,195 lekë dhe familjar 2,516 lekë në muaj, ndërsa në zonat urbane është dyfish më shumë.

UNIDO

Përmirësimi i produkteve bujqësore shqiptare për tregjet ndërkombëtare: Roli i akreditimit dhe trajnimit të vlerësuesve teknikë

(Vijon nga faqja 3)



dhe ndërkombëtare. Produkte të testuara në laboratorë të akredituar kanë më shumë mundësi të pranohen pa vonesa apo pengesa në tregjet globale, por ato gjithashtu plotësojnë standardet e cilësisë të kërkuara nga konsumatorët vendas dhe ndërkombëtarë, duke përmirësuar reputacionin dhe besimin në markën e tyre.

Besueshmëria e rezultateve të testimit ul rrezikun e kthimit të ngarkesave, gjobave apo dëmtimit të reputacionit, ndërsa përputhja me standardet ndërkombëtare të cilësisë rrit besimin e konsumatorëve dhe partnerëve tregtarë. Kjo ndihmon fermerët dhe NVM-të të fitojnë akses në tregje të reja, të rrisin vëllimin e shitjeve dhe të ndërtojnë marrëdhënie të qëndrueshme me klientët. Për më tepër, respektimi i standardeve të cilësisë përmes akreditimit nxit përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve të prodhimit dhe përpunimit, duke rritur efikasitetin dhe ulur kostot.

Akreditimi i laboratorëve është gjithashtu një avantazh për konkurrencën brenda tregut vendas, pasi siguron që produktet të jenë në përputhje me standardet më të larta të cilësisë dhe sigurisë. Kjo i bën fermerët dhe NVM-të më të aftë për të konkurruar jo vetëm në eksport, por edhe në sektorin vendas, duke siguruar që produktet e tyre të dallohen për cilësinë e lartë dhe përputhshmërinë me kërkesat e rregullatorëve dhe konsumatorëve.

Kontributi i UNIDO dhe qeverisë Zvicerane në Zhvillimin e Infrastrukturës së Cilësisë në Shqipëri

Mbështetja e UNIDO në trajnimet e vlerësuesve teknikë dhe përmirësimin e infrastrukturës së cilësisë është pjesë e përpjekjeve më të gjera, për të ndihmuar vendet në zhvillim të integrohen në ekonominë globale. Nëpërmjet projekteve të tilla, UNIDO ndihmon Shqipërinë të ndërtojë kapacitete të qëndrueshme në sektorë kyç, duke promovuar zhvillimin ekonomik dhe industrial.

Përfundim

Akreditimi i laboratorëve të testimit sipas standardeve ndërkombëtare dhe trajnimi i vlerësuesve teknikë janë elemente thelbësore në përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë së produkteve bujqësore shqiptare. Përmes këtyre përpjekjeve, Shqipëria po ndërton një infrastrukturë të fortë të cilësisë, e cila do të ndihmojë prodhuesit dhe eksportuesit të konkurrojnë me sukses në tregjet ndërkombëtare. Roli i DPA-së dhe mbështetja e UNIDO janë jetike në këtë proces, duke siguruar që standardet e larta të cilësisë dhe kompetencës të bëhen norma në sektorin bujqësor shqiptar.

ZHVILLIM RURAL

Luledielli i rrezikuar nga çmimi - Fermerët në Divjakë hoqën dorë nga gruri për këtë kulturë bujqësore, por tregu po tkurret

Thanas Veliu, fermeri nga Grabjani i Divjakës në 12 ha tokë ka mbjellë grurë dhe luledielli

Ai thotë se bukën e familjes nuk e do e siguroj nga gruri pasi e shiti me çmimin që nuk mb-

rova dhe e shita në komplekset blegtoriale. Por shumë fermerë të tjerë e kanë të pashitur", tha

sipërfaqet e mbjella po shtohen, por tregu po tkurret. Pavarësisht kësaj ai thotë se ka zgjidhje që fermerët të mos dështojnë edhe me këtë kulturë.

"Këtu mund të ishte shumë mirë një fabrikë për biodiesel sepse tek ne prodhohen shumë bimët vajore si luledielli, soja dhe misri. Për momentin farën hibride po e shesim me 150 lekë kilogramin ndërsa atë për konsum 70-80 lekë kg", tha Veliu.

Pas çdo sezoni bujqësor fermerët janë në kërkim të tregut, ata kërkojnë që subvencionohen si kolegët e tyre të rajonit që të mos konkurrohen nga prodhimet e importit të cilat vijnë në Shqipëri me një çmim shumë herë më të ulët se sa produktet që prodhohen këtu.



ulon as kostot e prodhimit.

"Kostot e grurit janë shumë herë më të lartë seç e shita me 25 lekë kilogramin. U dety-

fermeri Thanas Veliu.

Luledielli është kulturë e mirë bujqësore, por edhe Çmimi i saj rrezikon të bjerë pasi

Produktet e bulmetit, rekord absolut importesh në Gusht - Vlera arriti në rreth 767 milionë lekë, ose rreth 33% më shumë se vjet

Përgjatë pesë viteve të fundit duket se sektori i blegtorisë paraqitet në një rënie të qën-

Nga ana tjetër, importi i produkteve bulmetore, ku qumështi zë një peshë të kon-

produkteve bulmetore të importuara arriti në 4.5 miliardë lekë, ose rreth 8% më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Edhe në volum, pra në sasi, importi i produkteve bulmetore ka arritur një rekord të ri në muajin Gusht të këtij viti. Shifrat thonë se u importuan në sasi rreth 23% më shumë se vitin e kaluar.

Nuk mund të lemë pa përmendur edhe ndikimin që ka patur turizmi në rritjen e konsumit dhe për pasojë të kërkesës për këtë produkt, por edhe rënia e prodhimit të përmendur më lart ka një peshë të rëndësishme.

Ndërkohë, nga ana tjetër, rënia e prodhimit është ndikuar nga mbyllja e fermave si pasojë e emigracionit, apo edhe kostot e larta si pasojë e mungesës së subvencioneve. Kryesisht konkurrenca rajonale, falë mbështjes së këtij sektori në vendet përkatëse, po e tkurr sektorin e blegtorisë në vendin tonë.

Italia, Gjermania, Hungaria, Greqia dhe Serbia janë partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë në drejtim të importit të produkteve të bulmetit.



PRODUKTET E BULMETIT, REKORD ABSOLUT IMPORTESH NË GUSHT
VLERA ARRITI NË RRETH 767 MILIONË LEKË, OSE RRETH 33% MË SHUMË SE VJET

drueshme sa i përket numrit të krerëve apo edhe prodhimit blegtoral. Sipas të dhënave zyrtare të INSTAT, prodhimi total i qumështit ka pësuar një rënie prej 19.1%, ndërkohë që edhe produkti i mishit ka pasur një trend të ngjashëm. Në harkun kohor të 5 viteve prodhimi i përgjithshëm i mishit ka rënë me 13.6%. Nëse i referohemi vetëm prodhimit të qumështit, konkretisht, në vitin 2023 ka rënë me 7.17%, krahasuar me një vit më parë.

siderueshme, ka shënuar rekord absolut në muajin Gusht të këtij viti. Sipas shifrave, vlera e produkteve bulmetore të importuara në muajin gusht të këtij viti arriti në rreth 767 milionë lekë, ose rreth 33% më shumë se vitin e kaluar.

Kjo vlerë është më e larta që nga muaji Janar i vitit 2005, viti kur fillojnë të dhënat statistikore të INSTAT për këtë tregues. Nëse analizojmë shifrat për periudhën Janar-Gusht të këtij viti shohim se vlera e

Ilir Binaj emërohet drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve

Ilir Binaj është emëruar drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve. Vendimi u mor në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

Binaj ka një Diplomë Master për Kontabilitet Profesional (MPA) nga Universiteti i Teksasit dhe një Master në Administrim Biznesi (MBA) nga Universiteti Dallas Baptist.

Ai është anëtar i Institutit Amerikan të Kontabilitistit

Publik të Certifikuar (AICPA) dhe anëtar i Institutit të Audituesve të Brendshëm (IIA).

Binaj zëvendëson në këtë

detyrë Elidjana Çelaj, e cila u ngarkua përkohësisht në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.



Devulli, më pak fasule - I nxehti dhe mungesa e ujit për vaditje ka ulur me 75 % sasinë e prodhimit

Sasia e prodhuar e fasules në Devoll është ulur me 75% si pasojë e të nxehtit dhe thatësisë

Fermerët e fshatit Tren që janë marrë tradicionalisht me kultivimin e fasules këtë vit po marrin vetëm çerekun e prodhimit ndërsa tregojnë se kjo ndikon edhe në çmimin e shitjes.

Shkak sipas tyre mbeten ndryshimet klimatike pasi temperaturat janë rritur disa gradë ndërsa resurset ujore janë më të pakta.

Ulja e prodhimit sipas fermerëve ndikon në rritjen e kostos çka reflektohet edhe në çmim

Vitin e kaluar një kg fasule e prodhuar në vend arriti deri në 600 lekë dhe e njëjta gjë

pritet të ndodhë përsëri pasi fermerët thonë se e kanë të pa-

mundur të prodhojnë me kosto më të ulët.



Peshku mbret i Vlorës, speciet e rralla të detit që shpesh bien në rrjetat e peshkatarëve

Vitet e fundit specie të veçanta dhe të rralla për ujërat shqiptare janë bere tashmë pjesë e gjirit të Vlorës madje duke krijuar edhe habitatin e tyre

Në ujërat detit Jon tashme shikon specie të mund të shiheshin shumë rrallë pasi ato nuk kanë qenë pjesë e ujërave tona, por ndryshimet klimatike po sjellin gjallesa tepër rralla si peshku kimera, breshkat e detit, apo peshkaqenë.

Specialisti i peshkimit, Sherif Dyrmishaj thotë se peshkatarët në rrjetat e tyre kanë kapur edhe specia të rralla që jetojnë në ujëra të thella në zona të nxehta tropikale, që nuk kanë qenë më parë pjesë e gjirit të Vlorës, I tillë është dhe peshku mbret.

Tashmë habitatin e tyre në gjirin e Vlorës e kanë edhe fokat apo breshkat e ndryshme, ndërsa referuar specieve

grabitqare janë ndeshur edhe peshkaqenë të rrallë deri edhe

objekte studimi nga specialistet të cilët ndjekin lëvizjet



agresivë. Sinkron

Speciet e rralla tashmë janë

dhe mënyrën e zhvillimit të këtyre gjallesave.

Kultivimi i rrushit - Vit i mbarë në prodhim, por ra çmimi. Fermerët e Myzeqesë fokusohen te ulliri

Kultivuesit e rrushit në zonën e Myzeqesë po bëjnë llogaritë e një viti pune

Njësia administrative Allkaj, është një nga zonat që ka sipërfaqe më të madhe me vreshta në Lushnje, por kultivuesit thonë se ky vit ka ka

qenë i suksesshëm për ta.

Fermerët ankohen se ndryshe nga një vit më parë, prodhimi i tyre u shit me çmim më të ulët e rrjedhimisht në

xhepat e tyre ka më pak të ardhura.

Nëse vitin e kaluar një kilogram rrush u shite me 80 lekë kg, këtë vit ai nuk shkoi më shumë se 50 lekë për kilogram.

Por veç tregut të shitjes për këta fermerë një problem madhor mbeten edhe çmimet e larta të inputeve bujqësore, si dhe efektiviteti i tyre.

Të gjendur përpara këtyre situatave shumë nga këta fermerë kanë nisur të heqin dorë nga vreshtat duke e mbjellë tokën me ullinj, një kulturë që do më pak punë dhe ka një fitim më të mirë për t'a.



Financa e qëndrueshme gjithëpërfshirëse në Shqipëri, Historia e transformimit të FED invest

Financa e qëndrueshme gjithëpërfshirëse në Shqipëri, Historia e transformimit të FED invest

FED invest, EFSE (Fondi Evropian për Evropën Juglindore) Ministria e Punëve të Jashtme e Mbretërisë së Vendeve të Ulta, dhe Rabo Partnerships kanë bërë bilancin e 7 viteve bashkëpunimi në kuadrin e një programi të partneritetit publik-privat (PPP) në një Konferencë me titull: "Financa e qëndrueshme gjithëpërfshirëse në Shqipëri, Historia e transformimit të FED invest-it", e cila u mbajt në Hotel Plaza Maritim, Tiranë në 1 tetor 2024, me pjesëmarrjen e partnerëve EFSE, Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulta, FED invest, Rabo Partnerships, rregullatorëve (Banka e Shqipërisë dhe ASD), akademisë si dhe donatorëve. Në Konferencë morën pjesë edhe institucione simotra mikrofinanca nga Bosnje dhe Hercegovina (MI-BOSPO PARTNER MIKROFIN) dhe Kosova (KEP, AgroDev).

Konferenca shpalosi arritjen e këtij partneriteti që synonte rritjen e përfshirjes financiare dhe forcimin e zinxhirit të vlerave në sektorin e bujqësisë nëpërmjet zgjerimit të produkteve dhe shërbimeve të reja - duke mundësuar ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe njerëzore dhe zhvillimin e aftësive të reja dixhitale në FED invest, si pjesë e misionit të tij për t'i shërbyer ekonomisë rurale të Shqipërisë.

Programi e ka transformuar FED invest-in në ofruesin kryesor në Shqipëri të financave rurale të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Me mbi 94 mijë anëtarë dhe mbi 60 degë rurale dhe urbane në mbarë vendin, FED invest ka mbështetur me financime mijëra sipërmarrje të vogla dhe të mesme dhe në zonat urbane dhe semi-urbane. Falë mbështetjes së gjithanshme nga ekspertiza, konsulenca dhe financimet e partnerëve në Projekt, FED invest është transformuar në një ofrues modern të shërbimeve dhe përfshirjes financiare, një lider në financimin e bujqësisë dhe të zonave rurale. FED invest përfaqëson sot kooperativën financiare më të madhe në vend, me një strategji të qartë, sisteme moderne të IT-së, qeverisje të shëndoshë korporatave, bazë të gjerë e të diversifikuar anëtarësh, menaxhim operacional dhe financiar efikas, korniza bashkëkohore të menaxhimit të rrezikut dhe kapitalizmi solid. Ky partneritet ka fuqizuar klientët në të gjithë Shqipërinë, ka rritur transparencën dhe nivelin e shërbimit ndaj anëtarësisë, ka fuqizuar imazhin korporativ, duke nxitur prosperitetin dhe zhvillimin rural.

Ambasadori i Mbretërisë së Vendeve të Ulta, Shkëlqesia e tij, z. Reinout Vos, theksoi se, "Mbretëria e Vendeve të Ulta është e lumtur të mbështesë këtë projekt, duke mundësuar fuqizimin e fermerëve dhe sipërmarrjeve në zonat rurale".

Zj. Zana Konini, Kryetare e Këshillit Drejtues të FED invest gjatë fjalës së hapjes se, "FED invest përfaqëson, jo vetëm kooperativën financiare më të madhe në vend me mbi 90 mijë anëtarë, por dhe një institucion modern në të gjitha aspektet e qeverisjes dhe praktikave të punës, të specializuar në financimin e bujqësisë dhe agrobiznesit, me një ofertë unike shërbimesh financiare, por dhe të asistencës së biznesit Agri, nëpërmjet qendrës ABA dhe platformës digjitale ABA online. Në këtë konferencë gjendemi në vendin, kohën dhe me partnerët e duhur për të diskutuar dhe për të marrë përgjegjësitë tona për avancimin e mëtejshëm të financave dhe bujqësisë së qëndrueshme në vend".

Jacob Ole Nestingen, menaxher pranë Finance in Motion, EFSE DF u shpreh se, "ndër vite kemi punuar nga afër me FED invest-in për të mbështetur bizneset e vogla në Shqipëri. FED invest punon ngushtë me sipërmarrjet, kryesisht në zonat rurale, duke u mundësuar atyre financim, por edhe duke i mbështetur ato në rritje dhe zhvillim".

Rabo Partnerships, pjesë e Rabobank, Hollandë, bankë lider global në sektorin Agri dhe të Ushqimit, ishte ofruesi i ekspertizës në këtë projekt. Duke reflektuar mbi projektin, z. Bjorn Schrijver, Drejtor i Projektit, vlerësoi punën e përpjekjet e FED invest-it për energjinë, përkushtimin dhe guximin për të modernizuar sistemet dhe strukturat e tyre të brendshme – një proces shumë kompleks – për të zhvilluar produkte dhe shërbime të përshtatshme për segmentet e pa shërbyera të industrisë së shërbimeve financiare në Shqipëri. "Projekti me FED investon ishte energjik dhe i guximshëm falë ekipit që e mundësoi këtë ndryshim. Organizata trajton çdo sfidë që i del përpara dhe madje ka realizuar me sukses një iniciativë të sektorit publik dhe privat, së bashku me Bankën Qendrore të Shqipërisë, të mbështetur nga Banka Botërore, duke përditësuar ligjin shqiptar të kooperativave financiare, për të forcuar strukturën e sistemit kooperativ në Shqipëri, përvojë që shërbeu si shembull për kooperativat në tërësi në vendet e Amerikës Latine, Afrikës dhe Azisë.

Perlat Sulaj, Administrator i FED invest, nënvizoi se "gjatë



kohëzgjatjes së këtij projekti ne kemi financuar rreth 200 milionë euro, gjysma e të cilave ka shkuar për aktivitete të lidhura kryesisht me bujqësinë, blegtorinë, agroturizmin dhe zonat rurale. Numri i anëtarëve është rritur 2.5 herë që nga fillimi i projektit, duke aritur në gati 94 mijë anëtarë. Krahas kredive kemi ofruar një gamë të gjerë të produkteve si depozita, llogari rrjedhëse, produktet e pagesave utilitare etj. Hapa të rëndësishëm u hodhën drejt dixhitalizimit të shërbimeve, me futjen e shërbimit të FED Online, kredisë online 24 ore, FED Fin, nismës "Gruaja në FED", si dhe pagesat nëpërmjet portofoli dixhital, KlikoPago, të shoqëruara me programe të edukimit financiar e dixhital.

Me një vështrim mbi të ardhmen e bujqësisë së Shqipërisë, disa ekspertë të fushës ndanë pikëpamjet e tyre mbi rëndësinë krijimit të një sektori të qëndrueshëm bujqësor.

Corné de Louw, Menaxher i Lartë i Projektit në Rabo Partnerships theksoi rëndësinë e pasjes së një qasjeje afatgjatë për të gjithë ekosistemin: "Skemat e inputit të lartë – produktivitetit të lartë nuk janë gjithmonë pika e argjendit. Për shembull, në Holandë ne përjetojmë efektet negative klimatike të prodhimit të lartë në industrinë tonë të qumështit, gjë që ka një efekt të rëndësishëm në shoqërinë tonë. Gjithashtu, për të mbjellat, efekti i pesticidëve dhe plehrave është i rëndësishëm për t'u marrë parasysh për të mbajtur tokë të shëndetshme dhe pjellore. Për më tepër,

(Vijon në faqen 7)



FINANCIM

Si do të shpërndahen 15 milionë euro në bujqësi? - Skema e investimeve, financim deri 20 mijë euro për aplikant

Nga 30 shtatori janë hapur aplikimet për fermerët dhe grupimet e fermerëve që duan të përfitojnë nga skema e investimeve në bujqësi, ku në dispozicion janë vendosur 15 milionë euro.

Por si do të shpërndahen këto para? Udhëzimi i Ministrisë së Bujqësisë, i cili ka hyrë në fuqi, detajon se janë 5 skema të reja mbështetëse për fermerët.

Konkretisht, për ndërtimin e serrave diellore të reja me sipërfaqe jo më pak se 0.2 ha dhe jo më shumë se 2 ha për subjekt, përfshirë edhe instalimin e sistemit të ujitjes, masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 15 milionë lekë/ha për serrat e prodhimit të perimeve; jo më shumë 8 milionë lekë/ha për serrat e prodhimit të rrushit për tavolinë dhe jo më shumë se 4 katër milionë lekë/ha për serrat (tunelet plastike) të prodhimit të luleshtrydheve.

Për masën rrjeta për mbrojtjen e prodhimit nga breshëri në blloqet ekzistuese me pemë frutore, agrume dhe vreshta, përfitimi do të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 15.5 milion lekë/ha. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 1 hektarë dhe jo më shumë se 5 hektarë.

Referuar udhëzimit, do

të mbështeten fermerë për ndërtimin e ambienteve për mbarështimin e kafshëve dhe stabilimenteve për rritjen e shpendëve, me kapacitet jo më pak se 10 lopë, jo më pak se 100 të imta, jo më pak se 10) dosa dhe jo më pak se 10 mijë shpendë. Masa e përfitimit do të jetë në



50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 15 milionë lekë për subjekt.

Për blerjen e traktorëve, makinerive dhe pajisjeve për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në fermat bujqësore dhe blegtorale, masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 milionë lekë për subjekt.

Mbështetja për akuakulturën detare për koshat e rritjes së peshkut do të jetë në masën 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 20 milionë lekë për subjekt.

Për të përfituar nga masat

mbështetëse 9-13 aplikantët nuk duhet të jenë debitorë ndaj AZHBR, Ministrisë së Bujqësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Duhet të kenë shlyer sigurimet shoqërore në rastin e fermerëve individualë; të ketë tokën në pronësi dhe/ose me qira/

huapërdorje për të paktën 5 vjet, duke filluar nga viti i aplikimit; të ketë lejen përkatëse të ndërtimit sipas legjislacionit në fuqi, para lidhjes së kontratës.

Përfituesve nga masat e mbështetjes së investimeve 9-13, pas lidhjes së kontratës u paguhet paraprakisht deri në 30% të masës së financimit të kontraktuar, kundrejt garancisë së pagesës së lëshuar nga shoqëri sigurimi dhe/ose banka sipas përcaktimeve të kontratës. Aplikimet për masat mbështetëse të investimeve do të bëhen nga data 30.9.2024 deri më 8.11.2024, brenda orarit zyrtar.

Skemat e mbështetjes për bujqësinë - Kreu i Këshillit të Agrobiznesit: Fermerët e bashkuar kanë më shumë përparësi

Agim Rrapaj, kreu i Këshillit të Agrobiznesit foli për skemën e mbështetjes për bujqësinë. Në emisionin "Money Report", në ABC News Rrapaj sqaroi se fermerët e bashkuar kanë më shumë përparësi.

Gjithashtu theksoi se fondet e qeverisë do të vijnë të disbursohen edhe vitin e ardhshëm.

"Në skemën e re do të financohet 30% parapagim në momentin që lidhet kontrata me përfituesin. Po ashtu kjo skemë do të shtrihet edhe për vitin tjetër. Unë u bëj thirrje fermerëve që të aplikojnë sa më shpejt të jetë e mundur. E rithekoj se qeveria ka premtuar se do të ketë edhe një skemë tjetër edhe me sektorë të tjerë dhe veçanërisht sektorë që lid-


hen me zona malore. Skema që është në proces tani do të bëhet online dhe kjo është një tjetër lehtësi. Pra kjo do të shtrihet edhe në periudhën e vitit në vijim. Kryeministri ka thënë se do të ketë edhe një skemë tjetër në mbështetje të bujqësisë", tha ai.

Gjatë intervistës në studio ai u ndal edhe tek katër faktorë të rëndësishëm për bujqësinë; "Iniciativa për kooperimin siç po i mbështet skema kombëtare edhe banka duhet të ndjekin të njëjtin politikë që kooperimi të zërë vendin e duhur. Gjithashtu duhet mbështetur mekanizimi, inovacioni dhe digjitalizimi. Shpresojmë që edhe bankat të mbështesin këtë proces mekanizimit. Pikë tjetër me rëndësi është që sektori publik duhet të

rrisë buxhetin përmes akteve normative.

Më tej shtoi se shumë fermerë janë të paformalizuar, duke shtuar se duhet të lidhen më shumë kontrata për të përfituar kredi.

"Fermerët duhet të kenë orientim të tregut. Ne kemi një numër fermerësh që mbjellin për konsumin e tyre dhe ju mbetet një sasi për treg por është e vogël. Bujqësia shqiptare mund të bëhet konkurruese nëse do të rrisë mekanizimin në vjelje që është më i ulëti në rajon, të rrisë financimin dhe t'i krahasojë me rajonin në tërësi dhe të përmirësojë legjislacionin dhe ta përafrojë atë me Bashkimin Europian", u shpreh ai.



FED INVEST

Financa e qëndrueshme gjithëpërfshirëse në Shqipëri, Historia e transformimit të FED invest

(Vijon nga faqja 6)

z. de Louw sugjeron që të shikohet përtej bujqësisë, si më poshtë në zinxhirin e furnizimit ashtu edhe në humbjet pas vjeljes, për të optimizuar efikasitetin dhe qëndrueshmërinë në sistemet ushqimore. Një qasje gjithëpërfshirëse që përfshin të gjitha palët e interesuara dhe bashkon nevojat për shërbime financiare të atyre palëve të interesuara mund të bëjë një ndryshim. "Bashkëpunimi është kyç. Kjo është arsyeja pse jam i emocionuar që kemi të gjithë partnerët së bashku këtu në këtë skenë sot".

Rreth FED invest Shoqëri e Kursim Kreditit

FED invest është institucioni i parë i mikrofinancës në Shqipëri. FED invest përfaqëson organizatën kooperativë më të madhe në vend me një total të aktiveve që nga gushti 2024 prej mbi 8.3 miliardë lekë, portofol kredie mbi 6.6 miliardë lekë dhe total depozitash prej mbi 5.3 miliardë lekë. Me mbi 94 mijë anëtarë të shërbyer nëpërmjet 64 degëve në të gjithë vendin, anëtarësia e FED invest përfshin fermerë, sipërmarrës të vegjël, familje rurale dhe urbane, të përjashtuara nga shërbimet financiare bankare. Si lider në ofrimin e zgjidhjeve financiare të përbalueshme për popullsinë rurale, FED invest ka një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin social-ekonomik të Shqipërisë, me mbi 250 mijë kredi dhe gjysmë miliardë euro të injektuara në ekonomi përgjatë 32 viteve aktivitet. Për më shumë informacion rreth FED invest vizitoni <https://www.fedinvest.al>

Ministria e Punëve të Jashtme e Mbretërisë së Vendeve të Ulta

Ministria e Punëve të Jashtme është kanali përmes të cilit Qeveria Holandeze komunikon me qeveritë e huaja dhe organizatat ndërkombëtare. Ajo koordinon dhe zbaton politikën e jashtme holandeze. Ministria ka dy gjysma: selinë e saj në Hagë dhe misionet e saj jashtë vendit (ambasadat, konsullatat dhe përfaqësitë

e përhershme). Më shumë informacion: Netherlands embassy in Tirana, Albania | Netherlands Worldwide

Rreth Rabo Partnerships B.V.

Rabo Partnerships (RP), është një filial i plotë i Rabobank – një bankë ndërkombëtare lider në sektorin agri dhe të ushqimit. Misioni i RP-së është t'u sigurojë shoqërive në zhvillim akses të përmirësuar në shërbimet financiare, duke përdorur parimet e bashkëpunimit dhe ekspertizën bankare. RP-ja synon të arrijë segmentet e pashërbyer, qoftë fermerë të vegjël, NVM apo individë privatë. Për këtë qëllim RP ofron shërbime këshillimore. Si një partner strategjik, RP ndihmon institucionet financiare dhe organizatat donatore në realizimin e ambicieve të tyre strategjike, përmes transformimit të sektorit financiar duke krijuar institucione të qëndrueshme në shërbim të zonave rurale dhe të pashërbyera. Si pjesë e Grupit Rabobank, RP krijon partneritete strategjike që zgjerojnë rrjetin ndërkombëtar të Rabobank në tregjet në zhvillim, duke besuar fort në rëndësinë e agropotencialit të ekonomive lokale. Për më shumë informacion mbi Rabo Partnerships BV, ju lutemi vizitoni <https://www.rabobank.com/rabopartnerships>

Rreth EFSEs

Një fond investimi me ndikim i krijuar në vitin 2005, Fondi Evropian për Evropën Juglindore (EFSE) synon të nxisë zhvillimin dhe prosperitetin ekonomik në Evropën Juglindore dhe Rajonin e Fqinjësisë Lindore, duke investuar në suksesin e ndërmarrjeve mikro dhe të vogla, si dhe në përmirësimin e kushteve të jetesës për privatët. familjet. Duke qenë se aksesin në shërbimet financiare është çelësi për zhvillimin e këtij segmenti, EFSE fokusohet në ndihmën e sektorëve financiarë lokalë që të forcojnë aftësinë e tyre për të ofruar financim të përgjegjshëm për këtë grup të synuar. Krahas

aktivitetëve të saj të investimit nëpërmjet partnerëve lokalë, EFSE e shumëfishon ndikimin e saj nëpërmjet EFSE Development Facility, i cili ofron asistencë teknike, trajnime dhe mbështetje të tjera jofinanciare për sipërmarrësit dhe institucionet. EFSE u iniciua nga KfW Development Bank me mbështetjen financiare të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) dhe Komisionit Evropian. Ajo synon të nxisë zhvillimin ekonomik dhe prosperitetin në 16 vende në Evropën Juglindore dhe Fqinjësinë Lindore Evropiane. Duke qenë se qasja në financa është një çelës për zhvillimin e suksesshëm të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (MSME), fondi kërkon të përmirësojë aftësinë e sektorëve financiarë lokalë për të siguruar financim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm. EFSE kryesisht ofron financime afatgjata për MSME-të, nëpërmjet institucioneve partnere vendase të huadhënies. Finance in Motion GmbH, Gjermani, shërben si këshilltar i EFSEs dhe Hauck & Aufhäuser Fund Services SA, Luksemburg, vepron si menaxher. Për më shumë informacion mbi Fondin Evropian për Evropën Juglindore, ju lutemi vizitoni: <http://www.efse.lu/>

Për më shumë informacion mbi Finance in Motion, ju lutemi vizitoni: www.finance-in-motion.com

Rreth EFSE – DF

Instrumenti i Zhvillimit të Fondit Evropian për Evropën Juglindore (EFSE DF) u krijua në 2006 për të mbështetur mandatin e financimit të zhvillimit të fondit. Ai vendos asistencë teknike efektive, të synuar dhe inovative për të maksimizuar ndikimin dhe shtrirjen e fondit në vendet e synuara të EFSE. Akademia e Sipërmarrjes EFSE është një krah i EFSE DF që fokusohet në mënyrë specifike duke u ofruar sipërmarrësve burime, trajnime, mundësi për mbështetje financiare dhe mjete të tjera të nevojshme për t'i kthyer idetë e mira në sipërmarrje të suksesshme.



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



FED
invest 

**GJITHMONË
FINANCË SOCIALE**

AKTUALITET

Tirana Bank në mbështetje të të rinjve inovatorë: Ferma e Mjedrave, shembull i suksesit në rajonin verior

Tirana Bank vazhdon të mbështesë të rinjtë dhe idetë e tyre inovatore, që kanë të bëjnë me transformimin e ekonomisë lokale dhe ruajtjen e mjedisit. Një shembull i qartë i këtij angazhimi është investimi i saj në "Fermën e Mjedrave", një projekt inovativ në rajonin verior, mbështetur në kuadër të Konkursit të Bizneseve të Gjelbra

Tirana Bank vazhdon të mbështesë të rinjtë dhe idetë e tyre inovatore, që kanë të bëjnë me transformimin e ekonomisë lokale dhe ruajtjen e mjedisit. Një shembull i qartë i këtij angazhimi është investimi i saj në "Fermën e Mjedrave", një projekt inovativ në rajonin verior, mbështetur në kuadër të Konkursit të Bizneseve të Gjelbra.

Tirana Bank e përkrah këtë konkurs të organizuar nga Partnerët për Shqipëri prej tre vitesh tashmë, në përputhje të plotë me dy shtyllat e saj të Përgjegjësive Sociale – Edukim dhe Mjedis.

Konkursi i Bizneseve të Gjelbra ka si qëllim zhvillimin e ideve të qëndrueshme që kontribuojnë në ruajtjen e burimeve natyrore dhe rigjallërimin e traditave prodhuese.

Në vitin 2023, Tirana Bank financoi projektin fitues "Mjedrat e Danjës," i cili u prezantua nga Sentiljana Marku,

fermerja e parë që kultivon mjedra në Bashkinë e Vaut të Dejës.

Projekti u vlerësua për impaktin pozitiv në ruajtjen e biodiversitetit dhe për potencialin që ka në rritjen ekonomike lokale.

Me mbjelljen e mjedresë për herë të parë në rajonin e veriut, Tirana Bank ka ndihmuar në nxitjen e një modeli të ri prodhimi, duke ofruar mundësi punësimi për banorët lokalë, veçanërisht për gratë dhe grupet më pak të favorizuara.

Falë mbështetjes financiare dhe teknike të ofruar nga Tirana



Bank, Sentiljana pati mundësi të investonte në përmirësimin e proceseve të fermës së saj, duke blerë pajisje moderne që

lehtësojnë prodhimin dhe përpunimin e mjedrave.

E emocionuar që për së dyti vit radhazi ideja e saj mbështetet nga Tirana Bank, gjatë ceremonisë së shpalljes së fituesve, ajo u shpreh:

"Granti që përfitova nga Tirana Bank më dha mundësinë të realizoja ëndrrën time. Pa këtë mbështetje, nuk do të kisha arritur të zgjeroja fermën dhe të përmirësoja cilësinë e prodhimit. Tani, jo vetëm që kam mundësuar punësimin e banorëve të zonës, por edhe kam kontribuar në ruajtjen e biodiversitetit të

rajonit."

Pasi fitoi grantin e parë, Sentiljana Marku u rikthye në vend me një vizion të qartë për të zgjeruar fermën e saj.

Tashmë, me mbështetjen e dytë nga Tirana Bank, ajo synon të zgjerojë proceset operacionale të fermës, të rrisë numrin e punonjësve dhe të fuqizojë më tej ekonominë lokale.

Përveç rritjes së numrit të punonjësve sezonalë, produkti tashmë është certifikuar si "Organic," duke garantuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e prodhimit.

Ky sukses i "Fermës së Mjedrave" tregon qartë partneritetin strategjik të Tirana Bank me të rinjtë vizionarë të cilët kërkojnë të sjellin ndryshim real për komunitetin e tyre, sikurse punën e saj në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit dhe ekonomisë shqiptare.

Fermerët ende nuk kanë marrë naftën! Po kryejnë punimet e vjeshtës pa mbështetjen e premtuar për vitin 2024

Traktori këtë sezon bujqësor në tokat e fermerëve tanë nuk po punon me naftën pa akcizë, por ata po e blejnë me çmimin e tregut

Të gjithë fermerët që u shpallën fitues të Skemës Kombëtare 2024 deri më tani në llogarinë e tyre bankare nuk ju kanë kaluar paratë për naftën.

"Bujqësinë nuk e shikon askush, sikur të na jepnin subvencionim. Kam marrë një herë naftë, por të këtij viti jemi akoma në pritje."

Eksperti i bujqësisë Ilir Pilku thotë se kjo vonesë e ka një shpjegim, por punët e tokës nuk presin.

"Nafta nuk është dhënë sepse nuk është alokar fondi

nga Ministria e Financave, por ajo që duhet thënë është se duhet shpërndarë menjëherë"- shprehet Ilir Pilku.

Nafta e bujqësisë deri më tani ka shkuar në traktorët vetëm të shoqërive të bashkimit të fermerëve dhe jo atyre



individuale, një vendim i tillë ka shkaktuar pakënaqësinë tek bujqit e tjerë.

"Nafta e është e nevojshme në çdo muaj të vitit, por ajo duhet të shpërndahet menjëherë me qëllimin që fermerët të bëjnë një llogari të kostove në sezonin e ri bujqësor"- u shpreh Ilir Kapaj z/vërektor i UBT.

Vonesa e subvencionit të naftës pa akcizë, përkthehet për fermerët shtim të kostove të prodhimit, ndërsa për konsumatorin sjell një produkt më të shtrenjtë në tryezë.

"S'ka punëtorë, çmimet janë ulur" - Fermerët e zonës së Roskovecit përballen me vështirësi pas kthimit nga emigrimi

Kledis dhe Borana Cenka, çifti i bashkëshortëve nga fshati Vidhisht i Roskovecit, u kthyen gjashtë vite më parë nga emigrimi për të investuar në fshatin e tyre, duke ngritur 4.5 dynym serra diellore, aty ku kultivojnë kryesisht perime për eksport

"Sezoni i parë ishte i suksesshëm," thotë Kledisi, "por pastaj gjithçka ndryshoi.

Ata tregojnë se u përballën me vështirësi për shkak të mungesës së krahut të punës por edhe çmimeve të ulëta të tregut.

"Prodhimet po shiteshin aq lirë sa nuk mbulonim as kostot e prodhimit, madje disa herë u detyruam t'i hedhim për shkak të mungesës së kërkesës".

Ndihma e marrë nga skemat subvencionuese ishte minimale. Ata tregojnë se përfituan vetëm karburant,

por kaq nuk mjaftonte për të përballuar kostot e prodhimit.



Çifti që prodhon mbi 50 ton perime në një sezon kërkon do të braktisin fshatin dhe do të rikthehen në emigrim.

ndërrhyrjen e shtetit për rregullimin e tregut, përndryshe ata

Liqeni i Pogradecit ripopullohet me rasate të krapit autokton

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj vizitoi vaskat e prodhimit të rasateve në Lin të Pogradecit.

Në këto vaska bëhet shtimi i rasateve të krapit për ripopullimin e liqenit.

Denaj u shpreh se, në Ekonominë e Linit riprodhohen dhe rriten rasatet e krapit autokton, për ripopullimin e liqenit.

Ky proces ndihmon në ruajtjen e biodiversitetit të liqenit dhe mbështetjes së peshkimit artizanal, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe ekonominë lokale, nënvizoi ministria.

Rasati i krapit autokton është një risi që po rritet dhe zhvillohet në kushte ideale, me qëllim rivitalizimin e jetës peshkore dhe ofrimin e produkteve të freskëta dhe cilësore për



tregun shqiptar.

Kjo është risi pas 30 vitesh, pasi për herë të parë po fillohet të ripopullohet me krapin autokton Liqeni i Pogradecit, shpjeguan specialistët, të cilët shtuan se, ripopullimi është në fazat filltare dhe vitin tjetër do të fillohet të hidhen sasi të vogla.

Janë 4 vaska për mbarëshkrimin e rasatit të krapit, teksa po përdoren vaskat e vjetra të mbarëshimit të troftës përpara 30 vitesh.

Ministria vlerësoi punën e bërë dhe i përgëzoi pasi, u shpreh ajo, të kthehesh pas 30 vitesh me një produkt autokton të liqenit është fantastike.

Më shumë vaj këtë sezon! Rritet prodhimi dhe sipërfaqet e mbjella me rrënjë ulliri në Fier

Në zonën e Cakranit, në Fier, e njohur për kultivimin e ullirit, fermerët sapo kanë nisur vjeljen dhe grumbullimin për të prodhuar vajin më pas

Sipas përpunuesve, pritshmëritë këtë vit janë të mira, pasi edhe prodhimi në këtë sezon ka qenë i mbarë.

"Mendojmë që ky vit do të jetë shumë i mbarë dhe do të sjellë të ardhura të mira për fermerët e gjithë zonës. Kemi një rritje të sipërfaqes së kultivimit të ullirit në Cakran dhe mendojmë se janë mbi 600 mijë rrënjë ullinj. Kjo është rezultat i kthimit të njerëzve tek puna në tokë dhe mbjellja e ullirit.

Gjithashtu, në zonë ka investime të reja për përpunimin e ullirit, ku janë shtuar dy fabrika të reja, pasi përveç zonës së Cakranit, këtu përpunohet edhe ulliri i fshatrave përreth", tha Fredi Korcari, Administrator i Njësisë Administrative Cakran.

Në zonën e Cakranit ka një

fond prej më shumë se 600 mijë rrënjë ullinj dhe 11 fabrika vaji për përpunimin e ullirit. Edhe pse vitin e kaluar prodhimi ishte i pakët, sasia e prodhimit arriti mbi 50 mijë kuintal ullinj, duke dhënë një sasi të konsiderueshme vaj ulliri, ku pjesa më e madhe është eksportuar.

Çmimi i lartë në tregun botëror

të vajit të ullirit vitet e fundit ka rritur kërkesat për eksport, duke ndikuar kështu në rritjen e çmimeve. Për këtë arsye, fermerët e kësaj zone i janë përkushtuar më shumë shërbimeve ndaj pemëve shekullore dhe kultivimit të varieteteve të ndryshme, duke zgjeruar ndjeshëm edhe sipërfaqet me ullinj në këtë zonë.



BUJQËSIA BIOLOGJIKE 2025 DHE PËRGATITJET PARAPRAKE

Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

Për zgjerimin e peshës së Bujqësisë Biologjike, i cili pritjet të ndodhë gjatë vitit 2025, nevojitet që përgatitjet t'i fillojmë që tani. Vitin tjetër e më vonë, shteti dhe projektet parashikojnë ta mbështesin me më shumë fonde bujqësinë biologjike.



Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

Pjesa e parë

Terma dhe Koncepte

Paraprakisht para se të rreshtoj mendimet e mia për bujqësinë bio 2025, si një nga ekspektet që e themeluan këtë sistem bujqësie në Shqipëri (fillimi ishte viti 1997), dua të jap disa qartësime të termave dhe koncepteve profesionale.

Në praktikë zbatohen disa sisteme bujqësie. Me vetë termin "sistem bujqësie" kuptojmë tërësinë e bazës materiale që përdoret, shkencën dhe teknologjinë, njohuritë, të cilat janë në përdorim në një periudhë të caktuar historike". Në këtë kuptim sistemet e bujqësisë kanë vërtet karakterin e tyre historik. Sistemet e bujqësisë gjithmonë janë përsosur me përmirësimin e cilësisë së bazës materiale dhe me ndërgjegjësimin e rolit që ka vetë veprimtaria e njeriut në cilësinë e mjedisit.

Prej një shekulli e deri sot, janë praktikuar dhe praktikohen akoma sisteme bujqësie të cilët janë emërtuar si më poshtë:

- Bujqësi Natyrale,
- Bujqësi Konvencionale,
- Bujqësi e Integruar,
- Bujqësi Biodinamike,
- Bujqësia e Permikuturës,
- Bujqësi Organike/Biologjike/ Ekologjike

Këto termat e fundit janë sinonime dhe të barazvlefshme nga ligjet dhe rregulloret e vendeve të ndryshme. Si prirje botërore është ajo që sistemet e bujqësisë lëvizin drejt bujqësisë Organike/ Biologjike/ Ekologjike. Kudo në botë, sidomos në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim e sipër, punohet që të kufizohet sa më shumë sistemi i bujqësisë konvencionale dhe të shtohet sipërfaqja e sistemeve më miqësore me shëndetin e njerëzve dhe mjedisin.

Dy probleme madhore kanë dalë para bujqësisë sot në botë;

Sigurimi i një ushqimi të shëndetshëm, i cili lidhet direkt me shëndetin publik si dhe nevoja e domosdoshme e ecjes drejt neutralitetit ndaj ngrohjes globale.

Pse ligjet dhe rregulloret vendore dhe kontinentale i përdorin të tre termat (Organik/ Biologjik/ Ekologjik)?

Kjo sepse, secili nga këto tre terma realizojnë në praktikë atë që quhet "bujqësi miqësore" Bujqësia miqësore (nënkupto, Biologjike/ Organike/ Ekologjike) është ai sistem bujqësie, i cili harmonizon kërkesat e prodhuesit, konsumatorit dhe mjedisit, për një periudhë të gjatë kohore, pa krijuar konflikte biologjike dhe mjedisore. Nga kjo ka lindur termi tjetër shumë i përdorshëm "Bujqësia e Qëndrueshme". Këtë e realizon duke përdorur inpute (lëndë të para) si plehra, produkte të mbrojtjes së bimëve, farëra, ujë e pastër, qarkullimin bujqësor, ruajtjen e larmisë biologjike, element të cilat janë të padëmshme për shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe mjedisit në përgjithësi".

Pse nuk është rënë dakord që të përdoret vetëm njëri nga këto terma si Biologjike/ Organike/ Ekologjike, por gjejmë përdorime të ndryshme. Cili term është më i pranueshëm të përdoret?

E thënë shkurt, është çështje tradite. Sa më shumë kohë të jetë përdorur një term, aq më e vështirë është të ndryshohet, sepse krijon çorientim të konsumatorit, sa më e re

është përvoja, aq më lehtë mund të përshtatësh termin më të pranueshëm.

Vendet anglishtfolëse si Amerika dhe Anglia, në fillimet e veta përdorën termin "Bujqësi Organike".

Ky term zuri vend duke pasur parasysh vlerat e plehurat organik të kafshëve. Ky term u përdor për kundërpeshë të termin "Pleh kimik", i prodhuar nga industria, plehra të cilat kishin shfaqur defektet e veta mbi shëndetin e njerëzve, kafshëve, në gjallesave ujore etj. Nga ana tjetër, duke qenë se literatura shkencore dominuese ishte dhe është akoma në gjuhën angleze, shumë vende përshtatën termin "Bujqësi Organike" dhe "Produkt Organik". Gjithshtu donatorët që mbështesin këtë sistem bujqësie përdorin në dokumentet e tyre gjuhën angleze me termin "Organic" dhe për pasojë në shumë vende mbeti ky term.

Me kalimin e kohës, me shtimin e përvojës, vende të ndryshme në legjislacionet e tyre, gjithnjë e më shumë futën termin "Bujqësi Biologjike", dhe "Produkt Biologjik" Vendet më të mëdha evropiane si Italia, Gjermania, Franca, Spanja, Portugalia, Rumania si dhe vendet e vogla si Zvicra, Austria, Greqia përshtatën dhe përdorin edhe sot termin "Bujqësi Biologjike" dhe "Produkt BIO".

Vendet si Slovenia, Bullgaria, Serbia, Maqedonia dhe Kosova, në fillimet e veta përdorën termin "Bujqësi Organike", dhe për të mos krijuar konfuzion të konsumatorit e kanë ruajtur këtë term, "Organic". Edhe në Shqipëri kur shkruajmë në anglisht përdorim termin "Organic agriculture". P.sh., Shqipërisë i thërrasin edhe "Albania", por përdorimi vendas është "Shqipëria".

Po në Shqipëri si ka evoluar ky term teknik?

• Në ligjin e parë, miratuar në parlamentin Shqiptar në vitin 2004, u miratua termi "Bujqësi Organike", "Produkt Organik"

• Ligjin e dytë Nr. 106/2016, miratoi termin "Bujqësi Biologjike", i cili miratoi edhe logon kombëtare "BIO".

Ky term u konsultua gjatë me ekspertët tanë më të mirë të kësaj fushe si dhe me ekspertët e huaj që ishin konsulentë.

• Ligji i ri i vitit 2024, ka rikthyer pa argumenta termin e para 20 viteve "Bujqësi Organike" dhe "Produkt Organik"

Për kuriozitetin e lexuesit unë kam rastisur të jem në grupet e punës të dy ligjeve të para dhe kam dhënë mendime për ligjin e fundit.

Unë solla këtu mjaftueshëm argumente se cili term dominon në vendet evropiane, ku fermeri shqiptar ka dhe do të ketë gjithmonë tregun më të madh të eksportit të produkteve biologjike. Në Evropë dominon termi "Bujqësi Biologjike" dhe "Produkt BIO".

Pse Evropa ka preferuar të përdori temin "BIO"?

Termi bujqësi biologjike, përbashkon më mirë vlerat e bujqësisë miqësore. Kjo bujqësi i jep rëndësi jo vetëm procesit të prodhimit, por edhe produktit përfundimtar, të cilit i intereson në radhë të parë vetë konsumatorit.

• Termi "BIO" na tregon se produkti i prodhuar nga bujqësia biologjike ka më shumë jetë, vitalitet ushqimor (kujtojmë termin biologji, e cila studion organizmat e gjalla). Kujtojmë insektet e dobishme, insektet pjalmues, preparatet me bazë bakteriet, viruset, kërpudhat, janë organizmat të gjalla. Plehu organik i bagëtive nuk është i mirë se ai hahet direkt nga njerëzit, por produktet bujqësore të dala prej bimëve të plehëruara me pleh organik, kanë vlera më vitale ushqimore, janë më pranë, natyrale, biologjikes. Konsumatori këtë prek, produktin përfundimtar dhe nuk i intereson shumë procesi teknologjik i prodhimit të produktit.

Psh. konsumatori më shumë do preferonte një bluzë pambuku nga bujqësia konvencionale, se sa një bluzë prej fije lini por e prodhuar me standardin biologjik, kjo sepse perceptimi i pambukut është më tërheqës, më cilësor për konsumatorin, se sa termi "bluzë, nga lini biologjik".

Produkti BIO, duke qenë më tërheqës, madje përdoret edhe për të treguar vlerësime të tjera.

Qytetarët thonë se filmat shqiptarë janë "Filma BIO", sepse nuk ka lëndë të huaja, janë filma origjinalë.

• Për një vajzë të bukur pa u rënduar me shumë kremra, me frizura dhe veshje estravagante, i thonë një "vajzë BIO".

• Për një njeri babaxhan, i cili nuk gënjen kurrë, por

është origjinal, i thonë bisedat e tij janë "biseda BIO", pra pa shtesa, pa shtirje e fallsitetë.

• Termi Bio ka edhe përparësi fonetike dhe shkrimore. Është me bukur kur e shkruan dhe e dëgjon dhe shikon mbi produkt termin "BIO" se sa termin "Organik".

• Termi organik ka katër germa më shumë se sa termi "BIO". Nuk të shijon mirë kur shikon në logo ose etiketë "Produkt ORG".

Prandaj ka rëndësi që termi të evoluojë me evoluimin e shkencës, të gjuhës dhe vetë konsumatorit.

• Unë mbroj termin Bio, sepse edhe nga të gjitha institucionet shkencore evropiane quhen "Institute të Bujqësisë Biologjike". Gati të gjithë librat themelorë mbajnë titullin "Bujqësia Biologjike".

Edhe në Shqipëri tre botimet bazë të Universitetit tonë Bujqësor dhe instituteve private mbajnë titujt "Bujqësia Biologjike"

Edhe logo jonë kombëtare në përdorim është "BIO Produkt"

• Edhe certifikatat që lëshojnë trupat tona të certifikimit të fermtat biologjike, emërtohen "Certifikatë e Produktit Biologjik"

Natyrisht ne do zbatojmë termin e ligjit që do të miratohet Parlamenti Shqiptar, por si ekspertë të kësaj fushe, kemi për detyrë të japim mendimin për të bërë më të mirën për sot dhe për nesër.

Në ekonominë e tregut edhe përshkrimi i mallit ka rëndësinë e vet në marketing. Sa më thjeshtë, e më bukur logo dhe etiketa, më tërheqëse është për konsumatorët.

Kjo ishte në lidhje me termat e konceptet dominuese.

Pjesa e dytë

Informacion i shkurtër, për lexuesit dhe prodhuesit e rinj.

• Bujqësia biologjike në shkallë botërore zë rreth 2 % të sipërfaqes totale bujqësore, ose 96 milion hektarë.

- Në Europë rreth 10 %
- Në Ballkan nga 05 – 1 %
- Shqipëria nën 1 %

• Vendet me bujqësi biologjike më të zhvilluar janë: Lihtenshtein 30 %, Austria 25 %, Zvicra 20 % të sipërfaqes totale bujqësore.

• Vendet anëtare të BE-së janë angazhuar që bujqësia biologjike deri në fund të vitit 2030 të zërë 25 % të sipërfaqes totale bujqësore.

Dhjetë drejtime ku mendoj se duhet të përqëndrohemi për vitin 2025 dhe në vazhdim

1. Nxitja e fermerëve për aplikime, duke i bindur se bujqësia biologjike me produktet e saj "BIO" do të jenë gjithnjë e më të kërkuara si nga tregu vendas, ashtu edhe nga eksporti. Aplikimet për të kaluar në ferma biologjike, nuk u duhen lënë spontanitetit.

Bumi turistik, duhet të shoqërohet me rritjen e peshës së prodhimit, konsumit dhe eksportit të produkteve të certifikuara.

2. Bashkitë, Njesitë Administrative, Qendrat Rajonale të Bujqësisë (AREB), QTTB-të, Zyrat e Bujqësisë nëpër rrethe duhet ta mbështesin bujqësinë drejt sloganit "Për një bujqësi të qëndrueshme", slogan i cili është i shkruar në Strategjinë e Bujqësisë Shqiptare. Kjo statëgjji nuk mund të realizohet, nëse nuk punojmë çdo ditë për këtë. Zgjerimi i bujqësisë biologjike, nuk është thjesht si një investim ndërtimi, aksion siç ndodh me ndërtimin e një serre, e një blloku pemësh, e një qendre grumbullimi, por është proces që lidhet me të kuptuarit e prirjes së zhvillimit dhe krijimit të kushteve, që hap pas hapi këto procese të zhvillohen nga fusha e prodhimit, deri në dyqanet bio. Është proces, sepse kërkon kohë të bindet fermeri dhe këshilltari i bujqësisë për ndërrimin e inputeve, nga ato konvencionale në ato biologjike kërkon kohë për bindje dhe për të fituar siguri. Nuk është i sigurtë se si do të reagojnë konsumatorët ndaj produkteve biologjike. P.sh. përdorimi i feromoneve si

KËNDI I BOTIMEVE TË REJA PËR BUJQËSINË

BUJQËSIA BIOLOGJIKE 2025 DHE PËRGATITJET PARAPRAKE

(Vijon nga faqja 14)

mjete mbrojtëse ndaj insekteve të dëmshëm kërkon kohë që të bindë fermerin që të heqë nga përdorimi insekticidet konvencionale. Përdorimi i insekteve të dobishme në mbrojtjen e bimëve kërkon kohë që të bindë fermerin, se ato mund të zëvendësojnë insekticidet. Tradita dhe përvoja e fermerit është nga bujqësia konvencionale (e zakonshme). Edhe trajnimet, literatura, leximet rreth këtij sistemi bujqësie, kërkojnë kohën e vet që fermeri dhe agronomi të familjarizohen. Prandaj është proces. Është fare lehtë t'i tërheqësh fermerët "ejani aplikoni të merni falas fidana ul-liri ose hardhie", por nuk afrohen pa bindje kur u thua ejani aplikoni për mbështetjen financiare për ta kthyer fermën në fermë biologjike. Ky lloj spontaniteti ndaj fermerëve, e ka lënë bujqësinë biologjike akoma në nivele të ulëta.

Ah, sikur politika të bënte lutje dhe sqarime pse fermerët duhet të ndjekin bujqësinë biologjike, me atë përkushtim ashtu siç bëjnë në fushatat elektorale, të bindin fermerët se forca e tyre politike do jetë me e mira për ta, bujqësia biologjike do ishte shumë më lart se sa sot.

Në aplikimet në të ardhmen të nxitet mbështetja e fermave biologjike përreth restoranteve të mëdhej agroturistikë. Një model të tillë e ka krijuar Shoqata COSPE, Shkodër, me grupin e fermerëve të grupimit "Zadrime BIO". Këto ferma biologjike rreth MRIZIT TË ZANAVE, prej 4 vitesh janë të subvencionuara nga shteti. Këto ferma një pjesë të produkteve biologjike i shesin pikërisht te "MRIZIT I ZANAVE"

3. Të fillojnë trajnimet e agronomëve që do të trajnojnë

fermerët, si dhe trajnimin e fermerëve që aplikojnë bujqësinë biologjike. Mungesa e dijeve i mbanë larg agronomet ndaj bujqësisë biologjike.

4. Të grumbullohet literatura shqiptare me botimet mbi bujqësinë biologjike (Libra, revista, broshura, video profesionale) dhe të bëhen pjesë e bibliotekave të Ministrisë së Bujqësisë, QTTB-ve, AREB-ve, Zyrrave të Bujqësisë në rrethe, si bazë për përgatitjen e trajnimeve dhe të literaturës së thjeshtësuar për fermat biologjike. Rifillimi i botimit të revistës "BUJQËSIA SHQIPTARE", do ishte një ndihmesë për agronomët dhe fermerët bio dhe jo vetëm për ata.

5. Të fillojë hartimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Bujqësinë Biologjike. Të shtrihej ky plan deri në vitin 2030. Të vendoset një objektivi që deri në vitin 2030 të kemi aritur që, 3-4 % e sipërfaqes bujqësore të jetë kultivuar sipas standardit të bujqësisë biologjike. Sot sipërfaqja nën menaxhimin biologjik është nën 1 % të sipërfaqes totale bujqësore.

6. Të gjenden rrugë për nxitjen e importimit të inputeve (plehra, produkte të mbrojtjes së bimëve, farërave), të lejuara në bujqësinë biologjike. Tregu i sotëm i inputeve që lejohen nga standardi biologjik, është i varfër. Një dialog me tregtarët e inputeve është i domosdoshëm. Shteti duhet të miratojë një listë inputesh dhe një pjesë të vlerës së tyre ta mbulojë shteti. Kjo nxit tregtarët t'i blejnë ato. Sot për sot, meqenëse blihen me sasira të pakta, tregtarët nuk kanë interes që t'i blejnë këto inpute.

7. Të zhvillohen veprimtari promovuese për produktet biologjike, duke organizuar panaire të shpeshta të produkteve biologjike. Në bashkitë e mëdha të vendit, tregu i

gjelbërt të organizohej rregullisht një herë në muaj. Në bashkëpunim me shoqatat dhe kompanitë prodhuese dhe tregtuese të produkteve biologjike kjo është e mundur të organizohet.

8. Ligji i ri i cili po përafrohet me Rregulloren e re të BE-së Nr 848/2018 është në prag të miratimit. Do të ishte mirë që VKM-të, të miratohen sa më shpejt që të mundësojnë zbatimin e tij në praktikë.

Siç tashmë e dimë, mbyllja e këtyre procedurave të ligjit dhe vetë përmirësimi i treguesëve të bujqësisë biologjike, janë një nga kërkesat që e listës në procedurave që do të kontrollohen në kuadrin e të integritetit të Shqipërisë në BE.


9. Në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, është e nevojshme të vendoset një person me kohë të plotë, i cili do të ndjekë zbatimin e politikave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për produktet biologjike. Ky person koordinon punën mes të gjithë aktorëve të përfshirë në bujqësinë biologjike si fermat biologjike, trupat e certifikimit, shërbimin këshillimor të fermave biologjike, tregun bio, statistikën e bujqësisë biologjike, ndjek zbatimin e skemës së subvencioneve etj.

10. Do të ishte shumë e mirëpritur një konferencë kombëtare (takim kombëtar) e cila mund të emërtohej "Konferencë Mbi Produktet e Certifikuara Shqiptare". Zgjerimi i peshës së produkteve të certifikuara (jo vetëm i standardit biologjik), siguron edhe një treg të qëndrueshëm të eksportit, mes tyre edhe një imazh të mirë të Shqipërisë në sytë e botës, mbi ushqimin dhe mjedisin e shëndetshëm shqiptar.

Siç shikohet këto 10 vitet e fundit në botime, logo kombëtare dhe certifikatat për ferma, është përdorur termi "Bujqësia Biologjike" dhe "Produkt "BIO"



Botime për bujqësinë biologjike nga Universiteti Bujqësor dhe Instituti i Bujqësisë Biologjike, Durrës, (vitet 2005, 2013, 2024)



Certifikata për fermat biologjike

Logo Institutit të Bujqësisë Biologjike, Durrës

Kredi Agrobiznes 

A mund të blej makineri dhe
pajisje të reja bujqësore?

*SIGURISHT,
BËHET!*



 **CREDINS bank**

www.bankacredins.com

Tel.: +355 4 53 53 000

